



Date 11.11.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

Blerje kimikate dhe reagente

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Kimikate për trajtimin e ujit

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

7.409.639 (Shtate milion e katerqind e nente mije e gjashtëqind e tridhjetë e nente) leke pa TVSH Fondi limit është perlloritur nga Sektori i Planifikim -Raportim bazuar ne Urdherin Brendshem, ndersa kerkesat dhe specifikimet teknike jane hartuar nga Laborantja si me poshte:

<b>Emërtimi</b>	<b>Specifikime teknike</b>
Hipoklorit Natriumi,	me përqendrim të klorit aktiv 13-15%,
Reagent, Tableta për matjen e nivelit të klorit të lire 250 tableta /kuti	DPD Nr.1
Test kit për matjen e amoniumit	LCK 304 0.015-2.000 mg/l NH <sub>4</sub> -N; 0.02-2.50 mg/l NH <sub>4</sub> Temp e ruajtjes +2°C +8°C
Test kit për matjen e Fe	LCK 320, 0.2-6.0 mg/l Temp e ruajtjes +2°C +8°C
Test kit për matjen e Mg	LCK 326 0.5-50.0 mg/l Temp e ruajtjes +15°C +25°C
Test kit për matjen e fortesise	LCK 327 1-20°Dh
Test kit për matjen e Nitrite NO <sub>3</sub>	LCK 339 0.23-13.50 mg/l NO <sub>3</sub> -N / 1-60 mg/l NO <sub>3</sub> Temp e ruajtjes +15°C +25°C
Test kit për matjen e Nitrite NO <sub>2</sub>	LCK 341 0.015--0.600 mg/l NO <sub>2</sub> -N / 0.05-2.00 mg/l NO <sub>2</sub> Temp e ruajtjes +15°C +25°C



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

Test kit per matjen e Ca	Hach LCK 327 1.0-160mg/l
Endo nps	Nutrient pad set with membrane filter for ecoli 14053-47-N
Azide nps	Nutrient pad set with membrane filter for faecal bacteria 14051-47-N
mFC NPS	Nutrient pad set with membrane filter for e.coli and coliforma enterobacteria 14068-47-N
Alkool	90°
Detergjent larje provezash	Detergjent per larje me veprim te bute gerryes qe jep rezultat ne enet e qelqit. Perdoret per qelqe dhe pajisje laboratorike. I gatshem per perdorim qe pastron pa lene vija dhe mbetje.
Dezinfektues antibakterial -antiseptik për duar	Me baze alkoli 60% me paketim 500 ml, per larje duarsh
Doreza një përdorimshe	Te gomuara, rezistente, masa M
Bateri 4AA për matjen e turbullirës (turbidity meter hach) 2100OIS01	Bateri AA1950025
COD Vario Test LR 0-150 mg\l	skadencia pas dy vitesh
COD Vario Test MR 0-1500 mg\l	skadencia pas dy vitesh
NHP 600 Sodium Hydroxide	skadencia pas dy vitesh
Nitrification Inhibitor	skadencia pas dy vitesh
Quantofix Ammonium 10-400 mg/L	skadencia pas dy vitesh
Quantofix Nitrate/Nitrite	skadencia pas dy vitesh
Quantofix Phosphat 3-100 MG/L	skadencia pas dy vitesh
Bateri per kokat e shisheve BOD	energizer 2025 lithium
Bateri te vogla normale	Bateri AA, 1.5 V
COD LR Reagent Vials HI93754A - 25	HI93754A - 25

Hipoklorit Natriumi 13-15% klor aktiv

Hipokloriti i Natriumit (NaOCl) që do të përdoret për ujin e vlerat parametrike të shprehura në Rregulloren “ Cilësia e Ujit të Pijshëm” dale nga VKM Nr. 379 Prot., datë 25/05/2016.

1. Lëndë e pastër kimikisht;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

2. Lëndë me përqëndrim klor aktiv në masën 13-15 %;
3. Përbërësit dhe parametrat e hipokloritit të natriumit me 13-15% klor aktiv duhet të jenë sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore për këtë qellim;
4. Gjendja e lenget, ngjyrë e verdhë e çelët me densitet 1.13-1.28.

Ne lidhje me hartimin e kerkesave per kualifikim, ato jane hartuar sipas ndarjes se pergjegjesive te percaktuara ne Urdherin e Prokurimit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UK Shkoder ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është bazuar në Ligjin 162 datë 23. 12 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, dhe në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 30 “Sigurimi i ofertës”.

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është bazuar në Ligjin 162 datë 23. 12 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetë-deklarimit”, dhe në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”. Me anë të këtij kriteri AK kërkon të jetë i siguruar për gjendjen aktuale të OE, për përmbushjen me sukses të kësaj kontrate.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2022,2023, me nje vlere jo me te ulet se 40% e fondit limit te ketij prokurimi. **Kjo Kërkese konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.**

**2.2.2.**Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancin vjetor, për vitin financiar 2022, 2023 te konfirmuara nga administrata tatimore, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në përputhje me Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3: “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të jet e madhe se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës...”bazuar ne nenin 43 te VKM-në Nr. 285 datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore kërkohet bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30. 01. 2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”



*Bilancet per dy vitet e fundit jane kerkuara bazuar ne nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/4, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" dhe sherben per te njohur gjendjen financiare te operatoreve ekonomik ofertues*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.2.1 Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere prej 20% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vertetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontrates me sukses

---

- 2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar për hipokloritin e natriumit. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriuter është gjykuar si i domosdoshme, pasi për të garantuar furnizimin në mënyrë të vazhdueshme me cilësi sipas specifikimeve teknike duhet të jepet edhe autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar.

2.2.3 Në rastet kur operatorët ekonomik janë vet prodhues, duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të tipit A, për ushtrimin e këtij aktiviteti.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është gjykuar si i domosdoshme, pasi për të garantuar furnizim duhet që operatorët ekonomik ofertues në rastet kur janë vet prodhues të jenë të pajisur me leje mjedisore për ushtrimin e aktivitetit.

2.2.4 Në rastet kur operatorët ekonomik janë importues, duhet të jenë të pajisur me leje importi për hipoklorit natriumi, leshuar nga Ministria e Shëndetësisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi të garantuar furnizim duhet që operatorët ekonomik ofertues të jenë të pajisur me lejet perkatese nga Ministria e Shëndetësisë në përputhje me Urdhërin nr. 202, datë 23.05.2014 të Ministrisë së Shëndetësisë..

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën e cilësisë ISO 9001:2015, për sistemet e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente, të leshuar nga kompani të cilat njihen nga institucionet zyrtare Shqiptare dhe që janë të akredituara ( të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Certifikata kerkohet të jete e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi për të garantuar furnizimin në mënyrë të vazhdueshme me cilësi sipas specifikimeve teknike duhet që operatorët ekonomik ofertues të jenë të certifikuar për cilësinë e furnizimeve që ofrojnë sipas standarteve ndërkombëtare.

2.2.6 Operatori ekonomik duhet vërtetohet se hipokloriti i natriumit është i pershtatshëm në trajtimin e ujit të pishëm, duke paraqitur fletë analize të leshuara nga ISHP, duke pasqyruar rezultatet mbi parametrat e klorit aktiv dhe analize toksikologjike. Autoriteti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

Kontraktor do të pranojë analizen e ISHP-se vetëm me ato elemente që kryhen ky institucion (ISHP) për parametrat e klorit dhe analize toksikologjike.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi paraqitja e analizave të tilla garanton që produkti që do të furnizohet është brenda standarteve.

2.2.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumenta, që vërtetojnë pronësinë apo qeramarrjen **per AUTOBOT te posaçem**, për transportin e hipokloritit të natriumit, i cili duhet të jetë i certifikuar me ADR.

Nëse operatorët ekonomik ofertues transportimin e hipokloritit të natriumit do ta bëjnë me **depozita plastike IBC 1000 lt**, atëherë duhet të paraqesin dokumenta, që vërtetojnë pronësinë apo qeramarrjen për Kamion/kamionçinë, i cili duhet të jetë i certifikuar me ADR.

Çertifikimi ADR për mjetet e mësipërme kërkohej në përputhje me dispozitat e ADR sipas Ligjit Nr. 118 / 2012 “*PER TRANSPORTIN E MALLRAVE TE RREZIKSHME*” dhe udhëzimit nr. 6, datë 27.05.2015 “*Per procedurat e inspektimit të mjeteve, leshimit të certifikates së miratimit ADR, kushtet që duhet të plotësojë personi juridik për inspektimin e mjeteve ADR dhe tarifën e inspektimit*”. Ky kriter vendoset pasi hipokloriti i natriumit klasifikohet si produkt me ADR me kodin UN1791, ADR 1791 SOLUCION HIPOKLORIT NATRIUMI dhe klasifikohet në listën e lendeve vepruese për trajtimin e ujit të pijshëm duke paraqitur certifikatat përkatëse ADR të automjeteve.

Për të vërtetuar këtë mjet duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) Kur janë në pronësi duhet të dokumentohet që vërtetohet regjistrimi i mjetit (leje qarkullimi), certifikate pronësi, certifikate për transportin e mallrave të rrezikshëm. (ADR)
- b) Nëse mjeti është i marrë me qira, duhet të paraqitet kontrata e qerësë, gjithashtu leje qarkullimi, certifikate për transportin e mallrave të rrezikshëm. (ADR)

*(Kërkesa 2.2.7 do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përparë publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentat e deklaruara si më lart).*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin Nr. 118 / 2012 *PER TRANSPORTIN E MALLRAVE TE RREZIKSHME*. Ky kriter është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi për transportin e këtij produkti shumë të rëndësishëm,



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

duhen pajisje te testuara per te garantuar transport te sigurte dhe brenda parametrave te cilesise se kerkuar me qellim garantimin e cilesise se produktit dhe sigurine e qytetareve gjate transportit.

*Njesia e Prokurimit*